



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja **a**, dhe të nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismajl (Sherif) Vrapcit dhe Ramadan (Sherif) Vrapcit.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Pronat e paluajtshme në pronësi “pasuri shoqërore, rrugë publike e pakategorizuar”, pjesën e parcelës kadastrale, nr. 738-0, ZK Matiçan, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-00738-0, dhe pjesën e parcelës kadastrale nr. 1412-1, ZK Matiçan, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01412-1, ZK Matiçan, me pronën e paluajtshme në pronësi të:
 2. Ramadan (Sherif) Vrapcit, parcelën kadastrale nr. 739-39, ZK Matiçan e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-00739-39, dhe Ismajl (Sherif) Vrapcit, parcelën kadastrale nr.739-46, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-00739-46, ZK Matiçan.
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues urban „Mati I”. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.

- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0263756/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

